



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAVAJË

Nr. Prot

Date__ / __ / 2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data: 31.07.2019

Për: "Boshnjaku B" sh.p.k

Procedura e prokurimit: "PROCEDURE E HAPUR"

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-24193 - 05 - 28 - 2019

Objekti i kontratës : " **Rikonstrukcion i Rruges Drita, Lagjia Nr.2 Kavaje**"

Fondi limit : 12 325 000 (dymbëdhjetë milion e treqind e njëzet e pesë mijë) leke pa T.V.SH.

Afati kohor për ekzekutimin: 3 (tre) Muaj

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët • oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. " **2T "sh.p.k** nipt. K01731001M me vlere **11.924.200** (*njembëdhjetë milion e nentëqind e njëzet e katër mijë e dyqind*) leke pa TVSH .
2. " **Biba - X "sh.p.k,** nipt K32618815N me vlere **11.874.995** (*njembëdhjetë milion e etetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nentëqind e nentëdhjetë e pesë*) leke pa TVSH.
3. " **Boshnjaku. B " sh.p.k,** nipt K72627402H me vlere **10.830.500** (*dhjetë milion e tetëqind e tridhjetë mijë e pesëqind*) leke pa TVSH .
4. " **K.M.K" sh.p.k** , nipt L78223801E me vlere **7.986.150** (*shtatë milion e nente qind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e pesëdhjetë*) leke pa TVSH
5. " **Sark " sh.p.k** , nipt K52531415H me vlere **9.828.056** (*nentë milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e pesëdhjetë e gjashtë*) leke pa TVSH

Operatorët Ekonomike të s'kualifikuar:

1. " **Sark " sh.p.k,** me nipt K52531415H është skualifikuar pasi Shpk nuk ka paraqitur dokumentacion për shlyerjen taksave vendore ne 2018 ne Bashkin Tirane, sipas regjistrit historik.

-Nderkohe, ne vitin 2018 dhe 2019 ushtron aktivitet edhe ne adresat:

- Bashkia Maliq, objekti: “Ndertim porta dhe ura ne fushen e Maliqit”, kontrate e lidhur ne daten 18.02.2019.
- Bashkia Kruje, objekti: “Ndertim i linjes se ujesjellesit Bubq, lagja Doda”, kontrate e lidhur ne daten 31.12.2018.
- Bashkia Roskovec “Blerje e materialeve per mirembajtjen e rrugeve, veprave ujore, rrjeteve hidraulike, elektrike”. Duhet te paraqiste dokument qe ka shlyer detyrimet vendore prane ketyre njesive te qeverisjes vendore.
- Shoqeria “SARK” Shpk, nuk ka shlyer detyrimet e maturuara te energjise elektrike. Ky ofertues ka paraqitur vertetim me nr 1155 Prot., date 29.05.2019, ku vertetohet se: “Kerkuesi “Sark shpk” ... rezulton te kete ne total 0 leke detyrime per faturat e energjise elektrike, vlere e llogaritur deri ne daten 29.05.2019, duke perfshire faturen koherente te muajit prill 2019”. Procedura e prokurimit eshte zhvilluar ne daten 01.07.2019. Detyrim I maturuar konstiston ne pagesen deri ne daten e fundit te muajit te detyrimit te energjise elektrike per muajin paraardhes. Pra duke qene se data e tenderi eshte 01 korrik, ofertuesi duhet te vertetonte se ka shlyer detyrimet edhe per muajin maj, pasi detyrimet per muajin qeshor ka te drejte t’i paguaj deri ne fund te muajit korrik. Ky ofertues nuk ka paraqitur dokumentacion qe ka shlyer detyrimet e maturuara te energjise elektrike per muajin maj 2019.
- Shoqeria “SARK” Shpk, nuk ka shlyer detyrimet tatimore per sigurimet shoqerore per te punesuarit: Z. Ferdinand Hena, figuron ne listpagese me page 3546 leke; Z. Lulzim Gjini, figuron ne listpagese me page 3546 leke; Znj. Eriselda Agalliu, figuron ne listpagese me page 5909 leke; Z. Ardian Haxhiu, figuron ne listpagese me page 5909 leke; Z. Vasil Peci figuron ne listpagese me page 4727 leke; Z. Taip Doga nuk figuron ne listpagese.
- Znj. Eriselda Agalliu, rezulton te jete njekohesisht e punesuar prane shoqerise se ndertimit Venture Renco Terna, ne shkelje te plote te VKM Nr. 42 date 16.01.2008.
- Z. Ardian Haxhiu, rezulton te jete njekohesisht i punesuar prane Keshillit te Qarkut Vlore, ne shkelje te plote te VKM Nr. 42 date 16.01.2008.

Sa me siper, ky subjekt eshte ne kundersizim me Kreun IV te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008 ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, sipas te cilit drejtuesit teknik duhet te jene te punesuar me kohe te plote prane nje shoqerie ndertimit.

- Inxhinieri Rozina Tabaku, libreza e punes eshte fotogokpje, nuk figuron ne licencen e shoqerise. Shoqeria “Sark” Shpk nuk ka te punesuar si drejtues teknik I cili te figuroj ne licencen e shoqerise si

drejtues teknik. Nuk figuron ne listepagesat e shoqerise per muajin prill maj 2019. Inxhinierja ne fjale figuron ne listpagese me pagen 4272 leke, nderkohe ne kontrate e ka 24.000 leke, duke mos respektuar parashikimet ligjore per paga minimale, prej 26.000 lekesh,

- Inxhinier Z. Nikolla Kurilla, eshte inxhinier hidroteknik nderkoh qe ne dst kerkohet inxhinier ndertimi profili transport. Diploma eshte fotokopje dhe jo origjinale ose e njehsuar me origjinalin.
- Puna e ngjashme ne Korce, mungon situacioni perfundimtar I punimeve.
- Taksat vendore, mungojne vertetim leshuar nga Bashkia Roskovec, Divjake, Gjirokaster, kavaje dhe Has.
- Inxhinieri topograf Vasil Laci, ne 6 (gjashtë) muajt e fundit te kerkuar ne listpagesat e shoqerise figuron me pagat: 15.364, 15.364, 11.818, 11.818 dhe 4727 leke, ne kundershtrim me legjislacion e pages minimale dhe me nenin 45/2/d te sipercituar te LPP dhe me kreun IV te VKM 42, pasi figuron dhe si drejtues teknik.
- Mjekja Sofije Kryeziu Alushaj, figuron ne listpagese me pagen 5909 leke, ne kundershtrim me legjislacion e pages minimale dhe me nenin 45/2/d te sipercituar te LPP.
- Pllakashtrues Dritan Hoxha, nuk ka deshmi kualifikimi (IQT).
- Pllakashtrues Besnik Hatia, kontrata e firmosur nen pagen minimale, ne kundershtrim me VKM per percaktimin e pages minimiale. Nuk eshte paraqitur dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.
- Manovratori Bashkim Zenunaj me page sipas kontrates 24.000 leke, nderkohe ne listpagesat 5909, 4707 dhe 4707 leke. Nuk ka deshmi e aftesis profesionale per drejtim manovratori, lëshuar nga institucionet përkatëse.
- Manovratori Piro Gjoncaj me page sipas kontrates se punes 22.000 leke, nuk figuron fare ne listpagesa.
- Manovratori Taulant Xhafa me page sipas kontrates se punes 24.000 leke, ne listpagesat e tre muajve te fundit figuron me page: 9454, 7909 dhe 7909 leke.
- Punetori Myftar Belba, kontrata e firmosur nen pagen minimale, ne kundershtrim me VKM per percaktimin e pages minimiale.
- Ofertuesi ka paraqitur dokumentacion vetem per 3 punonjes nga 4 te kerkuar. Per te gjithë punonjesit e paraqitur ne permbushje te kesaj pike, operatori ekonomik “Sark” Shpk nuk ka respektuar legjislacion e pages minimale dhe nenin 45/2/d te sipercituar te LPP
- Autobetoniere AA691JC, nuk eshte as ne pronesi dhe as me qira, sic eshte kerkuar ne dokumentat e tenderit.

Kamioncina e paraqitur ne disponueshmerin e mjeteve me targe FR3215D, eshte kamion 3.5 deri 7.5 ton.

Gjithashtu mungon leja e transportit.

- Autobitumetricja e deklaruar ne disponueshmerin e mjeteve me targe AA650LZ eshte kamion, kjo vertetohen ne dokumentacionin e mjetit po ashtu edhe ne kontraten e qirase. Nuk ka paraqitur fotografi per kete mjet.
- Lidhur me kamionet, Operatori ekonomik "Sark" Shpk ka paraqitur dokumentacion te plote per mjetet me targe AA460DN, AA263JU dhe AA650LZ, nderkohe kamioni I katert me targe AA465GJ figuron ne pronesi te shoqerise "BBF" Shpk dhe kontrata e qiranese eshte nenshkruar nga personi fizik Bardhyl Kalivaci dhe ska document qe lidh kete person fizik me shoqerine "BBF" Shpk. Kamioni Gj1124B nuk ka çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme), te kerkuar ne dokumentat e tenderit.
- Te dy kamioncinat qe disponon Operatori ekonomik "Sark" Shpk, konkretisht me targe FR3215D dhe AA408VN, nuk kane çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme), te kerkuar ne dokumentat e tenderit.
- Per mjetin skrep eshte paraqitur kontrata e qirase Nr. 2003 Rep., Nr. 1101 Kol., date 21.06.2017 me shoqerine "Cobial" Shpk, nderkohe dokumentacioni shoqerues I kesaj kontrate eshte totalisht i palexueshem.
- Shoqeria "Sark" Shpk ka paraqitur dokumenta me permbajtte te rreme. Per kete procedure prokurimi kjo shoqeri ka paraqitur fature tatimore shitje me nr 37, date 13.05.2001, me ane te se ciles ka blere freze te perdorur nga shoqeria "Arni" Shpk, me NIPT K62701402R. Shoqeria "Arni" Shpk, eshte themeluar 13.02.2006 dhe eshte regjistruar si person juridik ne daten 01.03.2006.
- Fatura tatimore per tabela sigure eshte e pavulosur.
- Shoqeria "Sark" Shpk ka bere blerje me fature para dates se themelimit. Shoqeria "Sark" Shpk eshte themeluar ne daten 26.11.2004 dhe eshte regjistruar ne daten 31.01.2005.
- Shoqeria "Sark" Shpk ka mare me qira mjetin rrul me vibrim nga shoqeria "EMXH" Shpk, me kontrate te nenshkruar ndermjet paleve dhe jo kontrate qiraje noteriale.
- Kontrata e qirase se kamionit AA283JU, perfundon perpara periudhes se realizimit te punimeve esipas afatit te DST-ve.
- Kamioni me targe GJ1124B, nuk ka kontrate qiraje, mungon edhe leja e transportit.
- Te gjitha kontrat e furnizimit nuk jane akte noteriale.
- Shoqeria "Sark" Shpk nuk ka paraqitur dokumentacion qe verteton se posedon skrep, autobot uji, autopompe betoni.
- Lidhur me autobotin, Operatori ekonomik "Sark" Shpk ka deklaruar me shtojcen 10 se disponon autobotin me targe AA461NI. Nderkohe, sipas kontrates se qirase Nr. 3672 Rep., Nr. 1635 Kol., date 25.12.2018 me Bledar Memushi dhe sipas dokumentacionit te paraqitur ky mjet eshte kamion mbi 18 ton

dhe jo autobot. Kjo deklarate, rezulton një deklaratë e rremë, për qëllime kualifikimi dhe është në kushtet e parashikuara në nenin 13 pika 3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, pavarësisht nga çështja penale, që mund të ketë filluar, për një periudhë nga 1 deri në 3 vjet për keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, përcaktuar në nenet 45 e 46 të këtij ligji”. Gjithashtu, leja e transportit është në emër të subjektit “Zamir Memushi” dhe jo të pronarit Bledar Memushi.

2. "K.M.K" sh.p.k me nipt L78223801E është skualifikuar pasi ofertuesi ka mangësi të theksuar në dokumenta dhe në kontratat e mjeteve të mara me qera shumë nga kontratat janë bërë pa përcaktuar objektin e kontratës sipas pikës 9-c të DST,ve dhe certifikata e transportit është lëshuar për transport personal jo për të tjerë. Mungon certifikata për mallrat e rrezikshme, mungon akt zhdoganimi i asfaltoshtueses marrë nga caushi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë

1. Operatorin Ekonomik **"Boshnjaku B"** shpk me nipt K72627402H me adresë FIER Lagjja Bishanake, Rruga Skenderbeu, Nr. 8, Pranë karbuantit "Bolv - Oil", Zona kadastrale nr 8532

se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **10.830.500** (*dhjetë milion e tetëqind e tridhjetë mijë e pesëqind*) leke pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme. Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë autoritetit kontraktor Bashkia Kavaje, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, "**Biba - X "sh.p.k,"** sh.p.k oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **11.874.995** (*njëmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e nentëqind e nentëdhjetë e pesë*) leke pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 03.07.2019

Ankesa: Nuk ka patur ankesa

Adresa : Rruga “ Josif Budo”, Ndërtesa Nr. 10, Nr. Tel:055245555, www.bashkiakavajë.gov.al, info@bashkiakavajë.gov.al